

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GreeNNat Solar Park Ballsh” SH.P.K.

Sot, me date 29/12/2021 (dymije e njezet e nje), i pranishem:

- **Z. Shpëtim Shijaku**, shtetas shqiptar, lindur më 01/05/1962 në Fushë Krujë e banues po aty, mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr. 024433891 dhe me numër personal

i cili ne cilësinë e ortakut themelues shpall hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akt Themelimi në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me termat si me poshtë vijon:

NENI 1
EMËRTIMI

Themelohet nje shoqeri e se drejtes shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k.

NENI 2
SELIA

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën rruga “Mehmet Shehu”, pasuria nr. 205/1, Zona Kadastrale 1090, Ballsh, Shqipëri. Asamblea Ortakëve mund të vendose krijimin ose mbylljen e selive dytësore, filialeve, zyrave të përfaqësimit dhe degëve të shoqërisë ose transferimin e selisë së shoqërisë në qytete të tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar. Afati fillon nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin e Shoqërive Tregëtare deri sa të mbyllet me akte ligjore.

NENI 4
OBJEKTI

Objekti i Shoqërisë është:

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave të tyre ndihmëse. Përfshirë dhe pa u kushtëzuar vetëm në marrjen e të gjitha lejeve, licencave dhe autorizimeve paraprake/përfundimtare, institucionet përgjegjëse Shtetërore (qofshin këto organe Qëndrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Shitja me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjisë elektrike (vëndas apo të huaj), si dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjisë jashtë vendit.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 ALL (njqind mije) dhe është i përbërë nga 1 (nje) kuote.

Kapitali themeltar zotërohet si më poshtë:

- **Shpëtim Shijaku** zotëron 1 (një) kuote që perfaqëson 100 % (njqind) të kapitalit, me vlerë 100,000 ALL (njqind mije) lek secila kuote e ne total qe prebejne vleren e plote te kapitalit prej 100,000 (njqind mije) ALL

NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme dhe organi administrativ. Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë dhe vepron në përputhje me statutin e shoqërisë dhe ligjet në fuqi.

Organi i vetëm Administrativ i shoqërisë është Administratori i saj i vetëm,

- **Z. Florjan Almadhi**, shtetas shqiptar, lindur me 15.02.1989 ne Tirane e banues ne Tirane, Rr. Luleve, Njesia Administrative nr. 1, mbajtes e Leternjoftimit ID me Nr. dhe me numer personal I90215063D, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar; që do të qëndrojë në detyrë për një periudhë prej 5 vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, në përputhje me sa parashikohet nga ligji, nga akti i themelimit dhe nga statuti i shoqërisë. Administratori ka të drejta dhe kompetenca të plota për kryerjen e të gjitha veprimeve që do të konsiderojë të dobishme për realizimin e objektivave të shoqërisë, me përjashtim të atyre që kërkojnë miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, përpara organeve shtetërore dhe private.

NENI 7 PJESËMARRJA NË SHOQËRI TË TJERA

Ortakët mund të vendosin lirisht pjesëmarrjen në shoqëri të tjera si dhe të fillojnë çdo lloj aktiviteti tjetër tregtar në territorin e Shqipërisë, me kushtin që të mos jetë konkruues me atë të shoqërisë së themeluar prej tyre.

Cdo veprimtari qe bie ndesh me paragrafin e sipërpermendur nuk do te konsiderohet si konflikt interesi nese mer votbesimin e të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) te ortakeve.

NENI 8
LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 9
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ne te ardhmen ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që ka lidhje me të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do t'i drejtohen për zgjidhje si fillim me marrveshje mes palëve ose në të kundërt në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10
DISPOZITA FINALE

Ky akt themelimi u hartua në katër njësi të barazvlefshme e njejta në gjuhën shqipe, nga ortaku i shoqërisë, i cili njëkohësisht autorizon Florjan Almadhin për depozitimin e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

ORTAKËT THEMELUES

Shpëtim Shijaku

